



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.57

Prishtinë, më 24.6.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi dhe Ismajl Kurteshi.

Munguan: Sergjan Popoviq, Mufera Shinik, Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të KDI-së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Rendi i ditës:

Takim me rektorin e Universitetit të Zagrebit Prof. Dr. Damir Boras.

Nait Hasani, i uroi mirëseardhje rektorit të Universitetit të Zagrebit z.Damir Boras. Ai tha se marrëdhëniet ndërmjet Kosovës edhe Kroacisë janë të mira në të gjitha fushën e veçmas në fushën e arsimit, kjo për faktin se shumë studentë nga Kosova kanë përfunduar studimet në nivele të ndryshme në Universitetin e Zagrebit dhe japin kontributin e tyre në institucione arsimore dhe politike. Më tej, Hasani shprehu nevojën për ofrimin e ndihmës për Universitetin e Prishtinës në pranimin e studentëve dhe të interesuarve për studimet e doktoratës.

Salih Morina, tha se bashkëpunimi në mes të dy vendeve ka qenë edhe në të kaluarën, dhe si Komision kërkohet vazhdimin dhe forcimin e bashkëpunimit mes dy universiteteve edhe në të ardhmen. Ai tha se është në interes tonin që të kemi shkëmbim të studentëve dhe të stafit akademik mes dy universiteteve.

Shpejtim Bulliqi, theksoi se e çmon vizitën për faktin se nevoja e bashkëpunimit në fushën akademike mes dy universiteteve është me interes për vendin tonë e veçanërisht për Universitetin e Prishtinës. Universiteti i Zagrebit, ka dhënë kontribut të çmuar edhe në të kaluarën me staf akademik dhe kjo fazë e bashkëpunimit shpresoj që do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Universiteti i Prishtinës ka nevojë për kadro dhe shpresoj që universiteti juaj edhe në të ardhmen do të jetë i hapur për të ndihmuar rreth ngritjes së cilësisë së mësimdhënies.

Ismajl Kurteshi, tha se Universitetit i Zagrebit ka kontribuar në përgatitjen e kadrove për Kosovën, sidomos për kadrot e para viteve të 90-ta. Kosova tani ka disa universitete publike si dhe disa kolegje private dhe ka nevojë për ndihmën e universiteteve me traditë, siç është Universiteti i Zagrebit, sidomos për specializime të ngushta, në mënyrë që të kemi kadrot tona. Besoj që ky bashkëpunim do ti kontribuojë edhe miqësisë tradicionale ne mes te dy popujve edhe në mes të dy gjeneratave të akademikëve.

Damir Boras, rektor i Universitetit të Zagrebit, tha se kam kënaqësinë që marr pjesë në këtë mbledhje të Komisionit. Më tej, ai foli në pika të shkurta për historikun e Universitetit të Zagrebit si dhe për bashkëpunimin, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe stafit akademik mes dy universiteteve.

Universiteti ynë, tha Boras, është i hapur për studentë kosovarë që dëshirojnë të studiojnë në ndonjërin nga fakultetet e Universitetit të Zagrebit. Marrëdhëniet e mira që kemi dhe marrëveshjet e nënshkruara me Universitetin e Prishtinës, do të hapin mundësi për shkëmbim të studentëve dhe të stafit akademik, theksoi ndër të tjera Damir Boras, rektor i Universitetit të Zagrebit .

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**